



a

KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Bujqësisë
Periudha raportuese	Qershor 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Duke u bazuar në planprogramin e punës në Kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë, që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Përgatitjet për procesin e korrje-shirjeve 2018;
- Hapja e thirrjes për grante për shoqata nga RESI – austriak;
- Pjesëmarrje në punëtorinë për finalizimin e strategjisë afatmesme për bujqësi dhe zhvillim rural në komunën e Prishtinës;
- Përditësimi i të dhënave në sektorin e bujqësisë për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit - platformë online;
- Vizita tek fermerët përfitues të granteve nga Komuna e Prishtinës;
- Planifikimi i takimeve me fermerë dhe grupe të interesit;
- Pritet të zgjedhet përfituesi i tenderit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”;
- Vlerësimi i aplikacioneve për subvencione dhe grante në sektorin e bujqësisë;
- Vizita tek fermerët e komunës së Prishtinës.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:*

- Jemi të përgatitur për fillimin e korrje-shirjeve në komunën e Prishtinës;
- Është mbyllur me sukses afati për aplikimin e shoqatave në RESI-n austriak;
- Kemi marrë pjesë në takimin treditor, të mbajtur në Durrës, me temën “Punëtorja për finalizimin e strategjisë afatmesme për bujqësi dhe zhvillim rural”;
- Jemi në vazhdimësi të përditësimit të të dhënave në sektorin e bujqësisë për zhvillimin e sistemit të digjitalizimit platformës online;
- Brenda këtij muaji kemi bërë 12 vizita rutinore tek përfituesit e granteve nga Komuna e Prishtinës;
- Gjithashtu, janë vizituar edhe 5 fermerë të tjerë të komunës së Prishtinës për të parë për së afërmi problematikat me të cilat ballafaqohen gjatë kultivimit të kulturave bujqësore;
- Jemi duke realizuar dhe takime grupore apo individuale me fermerë, qoftë të shoqatave , fermerëve apo grupeve të interesit.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

- Është bërë përzgjedhja e operatorit ekonomik për realizimin e projektit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”;
- Ka filluar procesi i vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar për subvencione dhe grante në Drejtorinë e Bujqësisë.

4.1.2. *Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese*

- Nuk janë planifikuar për këtë periudhë

4.1.3 *Takimet me palë*

- Janë mbajtur 8 takime me palë.

5. Takimet me institucione të tjera

- Nuk ka pasur

6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

- Nuk ka pasur

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk ka pasur

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

- Nuk ka pasur.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh: pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Pritet të fillojë hapja e sezonit për korrje-shirje në pjesën e parë të muajit korrik;

- Vlerësimi i aplikacioneve për grante dhe subvencione në sektorin e bujqësisë;
- Do të realizohen vizitat në terren lidhur me procesin e korrje-shirjeve 2018;
- Në javën e ardhshme, do vazhdohet me monitorimin e projekteve të realizuara në bashkëfinancim me ADA-në austriake, me ç’rast do vizitohen fermerët përfitues të granteve;
- Finalizimi i strategjisë për bujqësi dhe zhvillim rural;
- Planifikohet të bëhet shqyrtimi i aplikacioneve të shoqatave të fermerëve në kuadër të projektit “Resi”;
- Pritet të funksionalizohet programi i digjitalizimit në bujqësi;
- Nënshkrimi i kontratës për realizimin e projektit “Vaksinimi i gjedheve, kafshëve të imëta dhe qenve me pronarë”.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme